



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronjat e) f) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Ligjin për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 19 paragrafët 1.5 dhe 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nenit 3 paragrafi 5 dhe 17 paragrafi 1.5 të Rregullores komunale nr.prot.01-016/01-0030667/22 për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Vendimit komunal nr.prot.01-413/01-0071612/23 për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2025-2026, si dhe Vendimit nr.08/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2024, miratoi këtë,

### V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE – “EKO-LLAPI” SH.A

#### Neni 1

Me këtë vendim i ndahen mjete financiare në shumë 30,000.00€ për subvencionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale - “Eko-Llapi” Sh.a.

#### Neni 2

Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Podujevës, kategoria e subvencioneve, (programi buxhetor 48005-Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik), dhe ka për qëllim dhënien e ndihmës financiare për funksionimin e Ndërmarrjes.

#### Neni 3

Shuma e mjeteve buxhetore sipas këtij vendimi bartet nga Komuna në xhirollogarinë bankare të Ndërmarrjes Publike Lokale - “Eko-Llapi” Sh.A.

#### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

#### Neni 5

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-400/03-0033713/24  
Podujevë, datë: 23 maj 2024



Kryetari i Kuvendit  
Krenar Hoxha